



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 25.2.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË TAMAD-it
PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2014

Auditim sipas marrëveshjes me TAMAD-in

Prishtinë, mars 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Ushtruesi i Detyrës Auditori i Përgjithshëm, Artan Venhari, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së TAMAD-it në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderan, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga Mjellma Dibra (Udhëheqës Ekipi) dhe Sabile Muli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia.....	5
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm.....	5
3 Rekomandimet e auditimit nga viti paraprak.....	6
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	7
Shtojca I: Raporti financiar	9

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra për Asistencë Teknike për Zhvillimin e Ministrisë së Bujqësisë është nënkomponentë e Programit të Mbështetjes së Danimarkës për Planin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës (2012-2015).

Një këshilltar ndërkombëtar afatgjatë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe funksionim e kontroleve të brendshme në Zyrën për Asistencë Teknike për Zhvillimin e Ministrisë së Bujqësisë. Ai gjithashtu është përgjegjës për raportim në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës - Fqinjësia me Bashkimin Evropian, i cili aprovon pasqyrat vjetore financiare të audituara.

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare, për periudhën nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor 2014 si dhe Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja stafin e Zyrës për Asistencë Teknike për Zhvillimin e Ministrisë së Bujqësisë për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2014 është ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat vjetore financiare.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në pasqyrat vjetore financiare; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Opinion

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200/1705 Opinion i Pamodifikuar)

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në pjesët e detajuara të këtij raporti, konkluzioni jonë i përgjithshëm është se cilësia e:

- Informacionit në pasqyrat vjetore financiare është e saktë dhe në pajtim me kornizën e raportimit; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është adekuate.

Më tutje, rekomandimet tona nga auditimi i vitit të kaluar janë adresuar plotësisht.

Për sa i përket menaxhimit të projektit, 42% e buxhetit total të projektit është përdorur deri në fund të 2014 për shkak të dizajnit të projektit dhe të vendimeve specifike të marra. Kjo pozitë do të duhet të menaxhohet në mënyrë aktive gjatë kohës së mbetur të projektit.

Edhe Zyrës së TAMAD-it në Kosovë edhe Ministrisë Daneze të Punëve të Jashtme u është dhënë mundësia për të komentuar draft raportin. Asnjë koment nuk është dhënë.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Zyrës së TAMAD-it (ZT) të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) në pajtim me Standardet e Kontabilitetit të Pranuara Ndërkombëtarisht për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka adresuar:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi; dhe
- Të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Cilësia e PVF-ve në përgjithësi ishte e mirë dhe të gjitha kërkesat e raportimit ishin plotësuar. Obligimet e tjera të raportimit të jashtëm ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200/1705 *Opinion i Pamodifikuar*).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Udhëzuesin për Menaxhimin e Ndihmës Daneze (UMND); dhe
- Pajtueshmërinë me legjislacionin e aplikueshëm vendor.

Ne konsiderojmë që regjistrimet në kontabilitet janë bërë konform planit kontabël në “economic” dhe linjat buxhetore janë në përputhje me formatin e Programit Danez për grante.

Nëse ka adresuar obligimet e tjera për raportim të jashtëm si:

- Parashikimi dhe kërkesat për transfere buxhetore;
- Raporti për fillimin e projektit;
- Raporte financiare gjashtë-mujore për MPJD-në; dhe
- Raporte gjashtë-mujore mbi aktivitetet e ZT-së për MPJD-në dhe Autoritetin Menaxhues pranë MBPZHR-së.

3 Rekomandimet e auditimit nga viti paraprak

Raporti jonë i auditimit për PVF-të e viteve 2012 dhe 2013 rezultoi me tre rekomandime kryesore. Këshilltari duhet të sigurojë që:

- Shpenzimet e paraqitura në PVF të klasifikohen sipas llojit të tyre;
- Çmimet për njësi të caktohen në kontratat për furnizim me material për zyrë. Për sa i përket hulumtimit të tregut, rezultatet e këtij procesi duhet të dokumentohen; dhe
- Gjatë aktivitetit të rekrutimit, përvoja e paraqitur në CV të mbështetet me dokumente shtesë.

Raporti mbi aktivitetet për gjashtë muajt e vitit 2014 ka paraqitur mënyrën dhe kohën brenda të cilës rekomandimet duhet të adresohen. Ne arrijmë në përfundimin se rekomandimet tona nga auditimi i vitit të kaluar janë adresuar plotësisht.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Buxheti total për periudhën katër vjeçare 2012-2015 është 1,025,333€, i cili mund të përshtatet sipas nevojës. Ne kemi analizuar linjat buxhetore të ZT-së dhe shpenzimin e fondeve sipas natyrës së shpenzimeve. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Linjat buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti i përgjithshëm	2014		2013		2012	
		Buxheti i planifikuar	Realizimi	Buxheti i planifikuar	Realizimi	Buxheti i planifikuar	Realizimi
Shpenzimet e veturës dhe transportit	25,467	2,933	2,977	2,933	3,748	16,667	12,259
Kontabilisti / Asistenca e Sekretarisë	82,100	24,000	25,084	22,800	22,876	2,933	1,402
Vozitësi/Korrieri				6,667	1,188	6,667	1,188
Pajisje për zyrë	2,800	200	738	267	100	2,000	795
Material zyrtar, internet etj.	6,800	800	1,410	533	953	2,000	330
Ngarkesa e bankës	1,250	200	272		360		82
Auditimi	3,000	2300	1,005				
Paraja e imët			7		34		
Kontraktimet ndërkombëtare afatshkurtra ¹	343,917	70,000	30,521	136,933	70,464	66,667	
Kontraktimet vendore afatshkurtra			16,682 ²		3,908		
Total:	465,333	100,433	78,697	163,476	102,442	96,933	16,057

¹ Kontratat afatshkurtra vendore dhe ndërkombëtare janë dy linja buxhetore që menaxhohen drejtpërsëdrejti nga MPJD

² Përfshin pagesën prej 15,901€ për kompensimin e këshilltarëve, shpenzimet e udhëtimit 214€ dhe ekzistencë €567.

Tabela tregon se deri në fund të 2014, buxheti i përgjithshëm është shpenzuar në 42%. Mbivlerësimet në lidhje me nevojat vjetore deri tani e kanë ndjekur projektin. Rezultati për 2014 shpjegohet me kërkesën e MPJD për të shtyrë një nën-projekt "Përcjellja e indikatorëve ARDP" për vitin 2015. Ky projekt është planifikuar në vlerë prej 30,000€.

Ne e marrim si të mirëqenë se kjo çështje do të adresohet nga MPJD.

4.2 Shpenzimet

4.2.1 Prokurimi

ZT kryen aktivitetet e prokurimit sipas procedurave të aprovuara nga MPJD-ja.

Ne kemi testuar procedurat e prokurimit dhe pagesat për këtë kategori. Gjatë vitit 2014, janë lidhur dy kontrata të reja (për material shpenzues për zyre dhe për shërbimet e internetit), ndërsa kontrata për furnizim me naftë është zgjatuar edhe për një vit. Kontrollat në këtë kategori ishin adekuate.

4.2.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit nënkuptojnë të gjitha ato blerje apo shpenzime që nuk i nënshtrohen procesit të prokurimit. Këto shpenzime përfshijnë edhe kontraktimet e këshilltarëve afat-shkurtë. Përzgjedhja e tyre rregullohet me procedurat e aprovuara nga MPJD-ja. Gjatë vitit 2014, ZT, kishte angazhuar këta këshilltarë në pajtim me kërkesat.

4.2.3 Kompensimet

Përveç një këshilltari senior, ZT ka të punësuar edhe një asistente administrative dhe një vozitës/zyrtar për logjistikë të cilët paguhen sipas kontratës. Ne kemi kryer rishikimin e kësaj llogarie ku kemi testuar mostrat e nevojshme.

Asnjë çështje nuk doli nga auditimi i shpenzimeve.

4.3 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm

ZT ushtron aktivitetin e saj në hapësirat e MBPZHR-së edhe shfrytëzon inventarin dhe pajisjet e kësaj ministrie. Vlera totale e pasurive të regjistruara në Regjistrin e Pasurive është 13,500€. Në fund të projektit këto pasuri do të barten në pronësi të MBPZHR-së.

Asnjë çështje nuk doli nga auditimi i pasurive.

Shtojca I: Raporti financiar

Raportet financiare të TAMAD-it Totali për periudhën 01.01.14 - 31.12.14

Emri	2014 (në €)	Emri	2014 (në €)
GJENDJA E BILANCIT		LLOGARITË E FITIMIT & HUMBJS	
PASURITË FIKSE		Qarkullimi	
Pajisje për zyrë	738.47	Grantet e marra nga MPJ - Danimarkë	-31.198.00
Totali pajisje për zyrë	738.47	Totali i qarkullimit	-31.198.00
		Interesi bankar i pranuar	-0.05
		Totali i qarkullimit	-31.198.05
PASURITË RRJEDHËSE		Kostot direkte	
Pasuritë likuide		Fitimi/humbja bruto	-31.198.05
Llogaria rrjedhëse bankare	-16.971.10	Shpenzimet e përgjithshme	
Paraja e gatshme	0.27	Pagat bruto (stafi)	1.750.00
Totali pasuritë likuide	-16.970.83	Pensionet e të punësuarve	87.50
Totali pasuritë rrjedhëse	-16.970.83	Sigurimi shëndetësor dhe i jetës	900.00
Totali i pasurive	-16.232.36	Automjetet - kostot rrjedhëse	
EKUITETI&DETYRIMET		Karburant & vaj për automjete	1.908.43
DETYRIMET RRJEDHËSE		Riparimi dhe servisimi	481.00
TVSH&taksat doganore		Kontrolli teknik i automjeteve	30.00
P.A.Y.E.	398.12	Sigurimi i automjeteve, taksa rrugore, e të tjera	195.13
Pagat neto	21.734.52	Shpenzime të ndryshme për motor	362.60
Fondi i pensionit	214.24	Totali i kostove rrjedhëse për automjete	2.977.16
Totali pagat & pensionet	22.346.88	Udhëtim & Zbavitje	
Totali detyrimet rrjedhëse	22.346.88	Udhëtime	214.25
Detyrimet afatgjata		Ekzistencë & Pije freskuese	567.14
Kapitali & Rezervat		Totali Udhëtim & Zbavitje	781.39
Fitimi neto/humbja viti aktual	-6.114.52	Shpenzimet Administrative	
Totali kapitali & Rezervat	-6.114.52	Telefoni	660.00
Totali Ekuiteti&Detyrimet	16.232.36	Internet	248.28
		Material për zyrë	171.19
		Totali - Shpenzimet Administrative	1.079.47
		Tarifat profesional	
		Tarifa për auditim dhe kontabilitet	1.335.05
		Tarifa për këshilldhënie	15.900.52
		Total -Tarifa profesional	17.235.57
		Ngarkesat financiare	
		Ngarkesat bankare	272.44
		Totali - Ngarkesat financiare	272.44
		Totali i shpenzimeve të përgjithshme	25.083.53
		Fitimi/humbja neto	-6.114.52

